

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEÇE KAI**

GSK-KPA-A-284/13

Prishtinë

2 Dhjetor 2014

Në çështjen juridike të:

M. R. K.

Pala ankuese

Kundër

Sh. A.

Istog

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët, Elka Filcheva-Ermenkova Kryetare e Kolegjit, Willem Brouwer dhe Sylejman Nuredini, anëtar, duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/200/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA38687) i datës 18 prill 2013 pas seancës gjyqësore të mbajtur më 2 Dhjetor, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e M. R. K. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/200/2013 të datës 18 prill 2014 për sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin 38687.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/200/2013 i datës 18 prill 2013, për sa i takon kërkesës së regjistruar në AKP me numrin 38687.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 6 korrik 2007 M. R. K. (në tekstin e mëtejshëm: Paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku kërkon vërtetimin e të drejtës pronësore dhe ri-posedimin e objektit afarist me sipërfaqe prej 48 m² që ndodhet në ngastrën nr. 1800/2 në rrugën Varoś, Komuna e Istogut. Në kërkesë theksohet se të drejtën pronësore në objektin afarist nuk mund ta ushtrojë për shkak të rrethanave që kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë në vitet 1998/99 ku përmendet data 14 qershor 1999 si data e humbjes dhe se i njëjti objekt është i zënë nga Ferid Sadikaj.
2. Me kërkesën e tij ai ka dorëzuar në mes tjerash edhe dokumentet vijuese:
 - Fletën poseduese nr. 828 të datës 11 tetor 2002 të lëshuar nga Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë i Komunës së Istogut. Sipas fletës poseduese, ngastra e kërkuar është pronë shoqërore dhe Kuvendi Komunal ka të drejtën e shfrytëzimit të saj.
 - Kontratën mbi Qiradhënien e Objektit Afarist, e datës 11 tetor 2002 e lidhur në Rozhajë të Malit të Zi e cila në nenin 2 parasheh që qiradhënësi, M. R. K. i lëshon objektin afarist me qera I. A. si qiramarrës për një periudhë kohore prej pesë vitesh.
 - Autorizimin, Vr.2659/2002 të datës 11 tetor 2002 të lëshuar nga Gjykata Komunale e Rozhajës me të cilën M.R. K. e autorizon I. A. për të filluar procedurat gjyqësore dhe për ta përfaqësuar atë para të gjitha institucioneve relevante lidhur me lirimin e objektit afarist.
3. Më 25 shtator 2008, AKP-ja ka bërë identifikim e pronës duke e vendosur një shenjë në vendin ku supozohej që gjendej objekti afarist. Doli se kjo ishte pronë komerciale dhe në posedim të Sh.A. (nga tani e tutje: Pala përgjegjëse në kërkesë).

4. Më 6 tetor 2008, pala përgjegjëse në kërkesë merr pjesë në procedurën para AKP-së, duke mohuar pretendimet e paraqitësit të kërkesës.
5. Për të mbështetur pretendimin e tij ai ka dorëzuar vendimin Nr.07-351-13 të datës 29 Mars 2000 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Komuna e Istogut ku i lejohet F. S. të ndërton një objekt montazh, të karakterit të përkohshëm si dhe Kontratën e Shitblerjes së objektit afarist ku theksohet se F. S. ia ka shitur të njëjtën palës përgjegjëse në kërkesë. Megjithatë, këto dokumente kanë të bëjnë me një ngastër tjetër, asaj me numrin 1800/1 në Istog dhe nuk janë konsideruar materiale për rezultatin e kërkesës, prandaj, Sekretaria Ekzekutive e AKP-së nuk i ka verifikuar ato.
6. Më 18 prill 2013 Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KPPK) me vendimin e saj KPCC/D/C/200/2013 ka refuzuar kërkesën. Në paragrafin 38-40 të vendimit grupor, i cili sipas vendimit të vërtetuar të datës 18 prill 2013 zbatohet veçanërisht për kërkesën në fjalë, theksohet se dokumentet që ka dorëzuar paraqitësi i kërkesës, nuk janë verifikuar nga ana e Sekretarisë Ekzekutive. Komisioni konstaton se paraqitësi i kërkesës nuk e ka vërtetuar të drejtën pronësore mbi pronën e kërkuar.
7. Më 15 gusht 2013, vendimi i është dorëzuar M. R. K. dhe ai ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme me datën 06 shtator 2013 (nga tani e tutje: Pala ankuese). Pala përgjegjëse në kërkesë ka pranuar vendimin me datën 30 korrik 2013 në cilësinë e palës përgjegjëse në ankesë dhe ai nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Pretendimet e palës ankuese

8. M. R. K. pretendon se KKPK ka konstatuar faktet në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë dhe ka bërë keq-aplikimin e të drejtës materiale.
9. AKP ka theksuar se Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur të verifikoj Kontratën mbi Qiradhënien e cila i ishte bashkangjitur kërkesës. K. ka kërkuar nga AKP që t'i ofroj atij provë se avokati i cili ka përpiluar kontratën dhe vula e të cilit është në kontratë, ka dorëzuar një raport në AKP që vërteton se kontrata nuk është autentike. Ai thekson se deklarata e bërë nga KKPK, e cila është pa raporte konkrete mbi verifikimin, është e papranueshme.
10. Në ankesë K. bënë një prezantim detaj të dokumenteve që ai ka dorëzuar në mënyrë që të vërtetoj pronësinë e tij.

Arsyetimi ligjor

11. Ankesa është dorëzuar brenda afatit 30 ditësh siç parashihet me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079 dhe është e pranueshme.
12. KKPK ka mbështetur vendimin e vet mbi faktin që AKP dhe Sekretaria Ekzekutive e KKPK-së kanë bërë një verifikim negativ të dokumenteve mbi të cilat K. e ka bazuar kërkesën e tij për pronësi. Sekretaria Ekzekutive e KKPK-së nuk ka mundur që *ex officio* të marr asnjë provë që do ta mbështeste kërkesën e K.. Bazuar në këtë, KKPK konstaton se K. nuk ka vërtetuar asnjë të drejtë pronësore mbi pronën e kontestuar.
13. Ankesa e K.përsëritë pretendimet e njëjta që ai i kishte bërë para KKPK-së. Asnjë provë e re nuk është dorëzuar me ankesën.
14. Kontrata e qiradhënies e vitit 2002 me të cilën ai ia kishte dhënë me qera objektin afarist palës së tretë nuk dëshmon se si e ka përfutuar ai të drejtën pronësore ndaj objektit afarist të kërkuar. Pala ankuese nuk ka dorëzuar ndonjë vendim mbi ndarjen apo provë tjetër që dëshmon të drejtën e shfrytëzimit apo atë pronësore mbi objektin afarist përkundër faktit që AKP i kishte dërguar atij një letër për kërkimin e informatave shtesë e cila ishte pranuar nga ai më 27 dhjetor 2012.
15. Gjykata Supreme konstaton se KKPK ka marrë një vendim të drejtë dhe të bazuar gjatë një procedure të plotë dhe të saktë. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme konstaton se nuk është bërë asnjë shkelje e së drejtës materiale dhe as nuk ka pasur vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike. Gjykata Supreme konstaton se ankesa është e pabazuar.
16. Në bazë të asaj që u tha më lartë dhe në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Ligjit 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

17. Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova Kryetar i Kolegjit, EULEX

Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it